




## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.07.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK-03-1995/14, për **z. Naim Imeraj**, Anëtar i Kuvendit Komunal të Istogut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

**II. Rasti** mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Naim Imeraj – Anëtar i Kuvendit Komunal të Istogut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejme Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Imeraj është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si Anëtar i Kuvendit Komunal të Istogut, Menagjer Financiar në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “Getrinke Vrella”, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat Ndërmarrja Shërbyese “Ass.Ing”.

Zyrtari i lartë z. Imeraj, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z.

Imeraj është bindur për kufizimin si pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-2697/14), në të cilën vërtetohet se i njëjti është larguar nga të qenurit person i autorizuar në biznesin Individual Ndërmarrja Shërbyese "Ass.Ing.

Zyrtari i lartë është i obliguar të bëjë deklarin rast për rast të interesave private Ligji Nr. 04/L-051, neni 13 (paragrafi 1) në të cilin thuhet:

Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

